



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Përqendrimi

Rasti: Transaksioni i shitjes së 90% të aksioneve që Eurosig SHA zotëron tek Insig Jete SHA, tek personat fizik z. Mane dhe z. Kastrati¹

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, në datë 28 prill 2017 është protokolluar shkresa me Nr. 180 prot, ku jemi njoftuar lidhur me kontratën e shitjes së 90% të aksioneve që Eurosig SHA zotëron tek shoqëria Insig Jete SHA.

Insig Jete SHA është një shoqëri e re e krijuar rishtazi¹, pas ndarjes së aktivitetit të shoqërisë Insig SHA e cila është ndarë në dy shoqëri: Insig SHA (jo-jete) dhe Insig Jete SHA. Insig Jete SHA ka si objekt ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit dhe ri sigurimit, nëpërmjet përgatitjes, ofrimit, nënshkrimit dhe zbatimit të kontratave të sigurimit “Jete”, sipas termave dhe klasave të përcaktuara në Ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit”, akteve të tjera normative dhe për të cilat është licencuar nga AMF.

Palët dhe objekti në këtë transaksion janë:

Shitësi: Eurosig SHA, shoqëri aksionare;

Blerësi 1: Z. Samir Mane

Blerësi 2: Z. Shefqet Kastrati

Shoqëria Target: “Insig jete” SHA

Objekti: Shitësi pranon t’i shesë blerësit te pare 45% të aksioneve dhe blerësit te dyte 45% të aksioneve.

Forma e përqendrimit është ajo e përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë nga personat fizike z. Samir Mane dhe z. Shefqet Kastrati mbi Insig Jete sh.a.

Shoqëria Insig Jete SHA si pasojë e këtij transaksioni financiar, ka ndryshuar strukturën e kapitalit të shoqërisë respektivisht:

Transaksioni që synon përfitimin e 90% të aksioneve, në kuptim të nenit 2, pika 1, germa b, nenit 10, pika 1, germa b dhe nenit 12 të Ligjit është përqendrim që duhet të autorizohet nga Komisioni i Konkurrencës.

Në këtë kuadër, ky transaksion i është nënshtruar procedurës së kontrollit të përqendrimeve, të parashikuara në Kreun e IV, nenet 53-64 të Ligjit si dhe në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

¹ Data e krijimit të shoqërisë është 23.12.2016, sipas ekstraktit të regjistrimit tregtar të shoqërisë.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al